



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL (i përmbledhur)¹

Tiranë, më 26.11.2020, ora 16.05

**Drejton mbledhjen -
Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit**

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datat 27.09.2019 dhe 24.09.2020:

- Aldona Sylaj,
- Ardita Buna (Alsula),
- Shaqir Hasanaj.

2. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datat 21.08.2019 dhe 24.09.2020:

- Ardita Buna (Alsula).

3. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatëve të mësipërm.

Marrin pjesë:

- | | |
|----------------------|--------------|
| 1. Vitore Tusha, | (zv/Kryetar) |
| 2. Fiona Papajorgji, | (anëtare) |
| 3. Arta Marku, | (anëtare) |
| 4. Saida Dollani, | (anëtare) |
| 5. Ludovik Dodaj, | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj, | (anëtare) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës.

2. Mimoza Arbi, përfaqësuese me autorizim e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

Vitore Tusha hap mbledhjen. Deklaron paraprakisht vonesën për shkak të disa impenjimeve që kishin disa nga anëtarët e Këshillit. Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Njofton se anëtarja e Këshillit, zonja Miranda Andoni, ka lajmëruar me *e-mail* se ka shfaqur shenja të Covid-19. Është njoftuar anëtari zëvendësues, zoti Nazmi Troka, por edhe ai ka njoftuar me *e-mail* se e ka të pamundur të paraqitet në mbledhje për shkaqe shëndetësore, si dhe për shkak të ngarkesës në punë.

Saida Dollani kërkon fjalën dhe si relatore e vakancës së shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 228/5/b të ligjit nr. 155/2016 dhe pikën 32 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, propozon të shtohet në rendin e ditës edhe vendimmarrja si do të procedohet në vazhdimësi për këtë pozicion vakant, duke sjellë në vëmendje që një prej kandidaturave është ndaluar dhe ka rënë nën tre numri i kandidatëve.

Vitore Tusha vijon me miratimin e rendit të ditës. Propozon të miratohet procesverbali i datës 23.11.2020, me përmbajtjen e të cilit janë njohur të gjithë dhe kanë dhënë vlerësimin e komentet, dhe propozimi i zonjës Dollani.

Anëtarët shprehen se janë dakord me rendin e ditës dhe me shtimin në rendin e ditës të të dyja propozimeve të paraqitura.

Vitore Tusha pyet nëse kanë diçka për procedurë Avokatja e Popullit dhe përfaqësuesi i Presidentit.

Erinda Ballanca shprehet se nuk ka gjë për të thënë dhe se është dakord.

Bledar Dervishaj: “Fakti është se sa i takon vakancës së Presidentit (*ish-Gjyqtarit Besnik Muçi*) fillimisht numri i kandidatëve nën 3 (tre), ka rënë që në shtator 2020 dhe aktualisht pas rikthimit nga gjykata të dy kandidatëve dhe pas rishprehjes me vendim nga KED numri ka rënë sërish nën 3, në të njëjtën ditë në datë 23.11.2020 me vendimmarrjen e KED-it për vakancën e Kuvendit. Kështu që siç u shpreha edhe pak më parë në parim do të dëshiroja që këshilli t’i vlerësojë të dyja në parim këto çështje që i përkasin të dy vakancave në të njëjtën gjëndje procedurale dhe jo vetëm njërin vakance. Sepse çfarë do të ndodhte. Po diskutojmë dhe u dha informacioni këtu që relatorja e vakancës së Presidentit (zj.Miranda Andoni) që nuk është sot prezent dhe që do të mund ta ngrinte proceduralisht këtë çështje ka shfaqur shenjat e Covidit, apo jo. Por në qoftë se relatorja do të testohet dhe rezultatet e testit konfirmojnë që është me Covid? Atëherë mund të ndodhemi përpara faktit që nuk mundet të vijë dot në mbledhjen e KED, për pjesën e mbetur. Atëherë për gjithë anëtarët e këshillit shtrohet pyetja si duhet të vazhdojë procesi për këtë vakancë? Këshilli duhet t’ia bëjë vetes këtë pyetje, prandaj unë e ngrita pak më parë si çështje. Këto çështje Këshilli duhet t’i shqyrtojë të dyja njëkohësisht si për vakancën e Kuvendit ashtu dhe për vakancën e Presidentit, se të dyja këto vakanca janë në të njëjtat kushte me një numër kandidatësh nën tre të ngelur aktualisht në garë. Nuk është se ka rënë numri tek njëra vakancë dhe s’ka rënë tek tjetra. E shikoj si shqetësim nisur nga fakti që ka lajmëruar relatorja e vakancës së Presidentit që jam me shenjat të para të Covid dhe bashkëshorti me covid, ndërkohë që me testim nuk vjen dot në punë kështu që ftoj këshillin ta diskutojë në parim dhe me shumë përgjegjësi këtë çështje për të dyja vakancat, sepse janë në të njëjta kushte për momentin. Ndoshta vakanca e Kuvendit pas vendimmarrjes së sotme të KED, mund të rezultojë në të njëjtat kushte apo edhe më keq sa i takon numrit të kandidatëve që ngelen në garë. Propozimi që bën relatorja e kësaj vakance zj.Saida Dollani që

vakancën që është për Kuvendin, ta përfshijë se si do veprohet në këtë mbledhje duhet të shqyrtohet bashkërisht në të njëjtin objekt edhe për vakancën e Presidentit. Dmth Këshilli duhet të përfshijë në rendin e ditës edhe fatin e diskutimit se çfarë do të bëhet edhe me këtë vakancë të Presidentit, sepse aktualisht janë në të njëjtat kushte. Secila nga këto dy vakanca ka aktualisht nga dy kandidatë të ngelur në garë, dhe nuk mund të mendohet se si do të jenë më vonë.”

Saida Dollani shprehet se kryesorja është që është nën tre, se sa është numri s’ka rëndësi.

Bledar Dervishaj: “Dakord. Është relatori që konstaton këtë fakt dhe njofton kryetarin i cili thërret mbledhjen sipas pikës 32 të rregullores. Po rregullorja vijon më poshtë me rregullat e tjera se çfarë bëhet po në këtë moment, me këtë gjendje procedurale, me këtë fazë. Është e dyta herë që vakanca e Presidentit gjendet në këto kushte, një herë në shtator 2020. Pas proceseve gjyqësore, u rikthyem në garë dy kandidatë dhe u bënë katër kandidatë, pastaj prapë në të njëjtën ditë në datë 23 nëntor u ndaluan nga kandidimi dy kandidatë dhe numri sërish ra nën 3. Ndaj duhen diskutuar nga këshilli në parim të dyja vakancat se janë në të njëjtën gjendje, nuk janë ndryshme. Dhe kur gjendja rëndohet referuar faktit që relatorja e vakancës të Presidentit, shfaq shenja Covid, sëmundje kjo që zgjat ndoshta deri në tre javë, (ishalla nuk është, dhe nëse është i urojmë shërim sa më të shpejtë), po në rast se do të testohet pozitive me Covid, atëherë për pjesën e mbetur te mandati të këtij këshilli (31.12.2020), lind pyetja, kush do merret me këtë vakancë? A do këtë mundësi këshillit të merret? Prandaj duhet që kjo çështje e ngritur për vakancën e Kuvendit duhet diskutuar po sot bashkë edhe për vakancën e Presidentit, prandaj ia parashtrijë këshillit, sepse e shikoj me shumë shqetësim.”

Mimoza Arbi shprehet se është dakord me rendin e ditës edhe me shtesën, por edhe me diskutimet dhe me kërkesën e paraqitur nga përfaqësuesi i Presidentit për t’u diskutuar.

Vitore Tusha shprehet se kërkesa e paraqitur nga relatorja Saida Dollani është procedurale dhe se nuk është paraqitur me shkrim. Po ashtu, duke qenë se çështja është konkrete, duhet të vlerësojë secili, duke filluar nga propozuesja, zonja Saida, arsyet për të cilat vlerësohet se është momenti procedural për ta diskutuar një gjë të tillë dhe aktin me të cilin duhet bërë.

Saida Dollani përgjigjet se legjislacioni nuk e kërkon që kërkesa të jetë me shkrim. Sugjeron se duke qenë se ka rënë numri nën 3 të njoftohet për këtë Kuvendi se çfarë është i gatshëm të bëjë, siç është vepruar në rastin e mëparshëm që është njoftuar Kuvendi, është pyetur nëse do të veprohet me shpalljen apo mes kandidaturave të lejuara do të procedohet më tej: “Sidoqoftë pra do të vazhdojmë të procedojmë më tej me nën 3 të numrit apo do të bëjmë rishpalljen për të proceduar me 3 e sipër të numrit? Pastaj pas marrjes së përgjigjes nga Kuvendi mendoj se jam e gatshme të them për hapat e mëtejshme në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin për kandidatët kandidatin kandidatët për të qenë koherente dhe në përputhje me ligjin, meqenëse në abstrakte kemi një të ndaluar që është më konkrete dhe me abstrakte edhe me konkrete po ashtu kemi një të lejuar dhe në abstrakte jemi duke shqyrtuar kandidaturën e tretë.”

Fiona Papajorgji shprehet se është çështje në fakt e diskutuar edhe më parë nga Këshilli dhe është konkluduar se nëse bie nën 3 numri i kandidatëve për ndonjë prej vakancave në shqyrtim nga KED-ja, shkresa përkatëse i njoftohet organit të emërtesës në momentin e përfundimit të të gjitha procedurave të vlerësimit të kandidatëve: “Në këtë rast për vakancën e shpallur nga Kuvendi nuk ka përfunduar ende procedura, pasi mund të kemi ankim për vendimet përkatëse dhe pse ka pak diferencim nga herët e tjera. Për këtë vakancë, një kandidat është ndaluar, çka përcaktoi dhe uljen nën tre të numrit të kandidatëve, dhe ndalimi është bërë sepse nuk ka plotësuar brenda afatit të duhur kohor deklaratën për pasurinë, pra jo për shkak të mosplotësimit të një prej kushteve të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji. Kështu që ka diferencë në këtë rast nga rastet e tjera. Gjithsesi në parim është që shkresa e institucioneve të

emërtesës t'u bëhet, por duhet mbajtur parasysh edhe fakti që Këshilli, në rastet që janë shfuqizuar vendimet e tij nga Gjykata Administrative e Apelit, ka për detyrë dhe kompetencë t'i rishqyrtojë kandidatët.”.

Vitore Tusha pyet relatoreen Saida Dollani nëse ajo propozon që Këshilli të pyesë Kuvendin se cili është vullneti i këtij organi në situatën që ndodhen me kandidatët e shqyrtuar në këtë vakancë, në kompleksitetin e kësaj situatë.

Ludovik Dodaj shprehet se po diskutohet e njëjta gjë që është bërë në mbledhjen e mëparshme, e njëjta procedurë, e njëjta klauzolë, të njëjtat pengesa dhe është rënë dakord që të informohen të dyja institucionet për vendet vakante në lidhje me situatën. Duke qenë se janë pothuajse të njëjtat diskutime, duhet të përfundojnë e pastaj Këshilli të dalë me vendim.

Arta Marku merr fjalën dhe shprehet se asgjë nuk e pengon Këshillin të paraqesë informacionin, duke treguar gjendjen faktike në të cilën ndodhen kandidatët: “Procedura e ankimit mund të ecë sipas ligjit dhe nuk mund të pengohet, madje kjo është detyrë që duhet bërë për situatën që ndodhemi, është një vullnet që ne nuk duam të kemi vonesa.”.

Fiona Papajorgji ndërhyr duke u shprehur se kërkesa sipas pikës 32 të vendimit nr. 4 të KED-së nuk është thjesht për kërkim mendimi dhe se znj. Dollani propozoi diçka tjetër.

Saida Dollani ndërhyr dhe shprehet se sipas pikës 32 “*thërret mbledhjen e Këshillit për të vendosur mbi mënyrën procedimit të mëtejshëm për atë pozicion vakant*” ndaj për këtë ka kërkuar të shtohet rendi i ditës dhe propozon që Këshilli t'i drejtohet Kuvendit e t'i kërkojë mendim. Se çfarë mund të bëjë pastaj gjykata administrative, është tjetër gjë.

Bledar Dervishaj pyet se kuptimi procedural i asaj pike do të thotë se Këshilli do marrë vendim pezullimi?

Saida Dollani përgjigjet se nuk po propozon pezullimin, por që të kërkohet mendim se çfarë të bëhet më tej.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shprehet se kjo është diskutuar edhe vjet, por ishte situatë tjetër se kishte më shumë kohë: “Tani jemi shumë ngushtë me kohë dhe institucioneve duhet t'u japim kohën e duhur, sepse Kuvendi ka procedura më shumë se Presidenti që e menaxhon vetë procedurën. Kuvendi menaxhon një proces të tërë. Dhe në këtë aspekt konstatoj që edhe përfaqësuesi i institucionit, por edhe vetë drejtuesit publikisht të institucioneve që mund të jenë normalisht vetë pjesë e kësaj mbledhjeje, janë shprehur që presin nga KED-ja veprim dhe pastaj na lini fjalën ne të shohim për procedurën jeni saktë apo s'jeni saktë. Ato kanë të drejtën që nëse ne po ua çojmë mendimin dhe nuk janë dakord, mund të thonë e kthejnë mbaron procedurën dhe pastaj hajde tek unë. Shprehet që të çohet informacioni, duke njoftuar organin që ka kandidatë për të cilët është vendosur ndalimi dhe kanë të drejtën e ankimit që është një e drejtë që nuk mund të mohohet se nuk i takon Këshillit të dalë mbi ligjin. Është një tip rezeve që ne i lëmë institucionit që shikoni se është edhe ky potencial, me një informacion më të detajuar se sa thjesht që ka rënë në dy. Pavarësisht se ato kanë informacion nga përfaqësueset ligjore, duhet formalizimi i kësaj me shkresë zyrtare.”.

Vitore Tusha pyet Avokaten e Popullit nëse ka ndonjë mendim për këtë procedure.

Erinda Ballanca: “Ne në fakt kemi qenë promotorët e idesë t'i japim kandidatëve kohë të mjaftueshme për të bërë ankim sepse rrezikohej apo kishte problematikë që mund të kthehej përsëri procesi. Nëse do ktheheshin vendimet nga gjykata çfarë mund të ndodhte me procesin dhe numrin që do dërgohej në ndërkohë. Gjithashtu problemi tjetër është se nëse në këshill do të kalohet rasti i vakancës së Kuvendit me një kandidat është e qartë që KED paracakton të vetmin fitues, nuk do ketë mundësi zgjedhje nga ana e Kuvendit, kështu që dhe në një farë mënyre edhe kjo pjesë e procesit përsëri do të ketë një problem. Këto kanë qenë dy shkaqet për të cilat kemi shprehur edhe më parë mendim dhe kemi thënë që duhet t'u garantohet institucioneve të emërtesës mundësia e zgjedhjes. Sigurisht që kjo duhet t'i garantohet nga KED-i, pra KED-i ka për detyrë të çojë tre kandidate efektive që ata (organet e emërtesës) të bëjnë një zgjedhje mes tre kandidateve. Por nga ana tjetër janë organet e emërtesës të cilat kanë

vlerësuar se ata mund të heqin dorë nga kjo e drejtë sepse nuk është detyrimi i tyre të zgjedhin midis 3 kandidatësh, por është e drejtë e tyre të zgjedhin mes 3 kandidatësh ky ka qenë interpretimi që është bërë deri më tash nga organet emërtesës edhe për vakancat e mëparshme. E vetmja çështje që shtrohet tani për diskutim, i vetmi faktor i ri është faktori kohë e konkretisht se sa shumë vonohet në kohë ngritja e Gjykatës Kushtetuese nga zbatimi i këtyre dy elementeve apo tre elementeve që janë shumë të drejtë dhe që kemi trajtuar e kemi marrë parasysh dhe i kemi dhënë deri tani. Në gjykimin tim nëse ne do të vazhdonim të të nisnim të njëjtën procedure ky KED do ta kishte pothuajse të pamundur të përfundonte të gjithë procesin e vakancave deri në përfundim të mandatit të tij njëvjeçar. Edhe për shkaqe shëndetësore përveç të tjerave sepse shtohet edhe një problem që është një shkak shëndetësor i cili ka një problem potencial e nuk kemi garanci që do të vazhdojmë që ky këshill do vazhdojë të jetë në përbërje të plotë dhe të dihet se kuorumi kështu është. Sa më shumë mundësi t'i japë KED-i vetes për ta realizuar këtë proces mendoj se më mirë do të ishte, dhe në këtë moment mendoj se prevalon fakti se vendi duhet të ketë një Gjykatë Kushtetuese. Ndaj një procedure e cila mund të ketë një problem apo më saktë mund të ketë jo një problematike por mund të ketë një diskutim në lidhje me garantimin efektiv të parimit të procesit të rregullt ligjor prevalon e para. Se ne nuk është se jemi duke mohuar këtë të drejtë për kandidatët, KED-i nuk po mohon me këtë vendimmarrje procesin e rregullt ligjor për këto candidate por për zbatimin e një standardi më të lartë e konkretisht për ta garantuar në mënyre efektive këtë proces. Kështu që unë mendoj organet e emërtesës mund të vihen përpara zgjedhjes në këtë moment do të jetë në vlerësimin e tyre se çfarë do të bëjnë pastaj e vlerësojnë ata se çfarë mund të ndodhë me këto dy vakanca. Faleminderit!"

Vitore Tusha i jep fjalën përfaqësueses së kryetarit të Kuvendit.

Mimoza Arbi: "E nderuar znj. zv/Kryetare, dëgjuam anëtarin e KED Saidën që është dhe relatore për kandidaturat për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë 23.09.20 mbështes çfarë sugjeruan dhe anëtarët e tjerë në lidhje me situatën që është KED dhe gjendja e kandidaturave që po shqyrtohen nga KED për vendin vakant si të Kuvendit si dhe të vendit vakant të shpallur nga Presidenti, mbështes sugjerimet e dhëna nga Av.Popullit në diskutimin e saj për situatën në të cilën ndodhen kandidaturat për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë. Në lidhje me ecurinë e procesit të gjetjeve dhe vlerësimit të kandidatëve nga KED, është bërë me dije Kryetari i Kuvendit të cilin unë përfaqësoj në këtë Këshill dhe natyrisht është diskutuar dhe me deputetët në Kuvend në organet drejtuese të Kuvendit. Kuvendi për këtë vend vakant për të cilin diskutohen kandidaturat ka bërë 3 (tre) shpallje. Është shpallur për herë të parë në dt 28.08.2018 ku Kuvendi shpalli procedurën e aplikimit për vendin vakant për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese me qëllim plotësimin e vakancës të parakohshme e krijuar për shkak të mbarimit para afatit të mandatit të ish gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese Z.Fatos Lulo. Pas vendimit të KED për shkak të rënies të numrit të kandidatëve, referuar kushtetueses dhe ligjit që përcakton minimumi 3 kandidatë, Kuvendi përsëri rishpalli procedurën me 21.08.2019 dhe përsëri me vendimin e KED i cili na kërkonte si organ emërtesë të vlerësonim nevojën e rishpalljes apo jo, Kuvendi përsëri rishpalli procedurën këtë vend vakant më datë 23.09.20 dhe në të tre rastet është konstatuar pikërisht se për këtë vend vakant numri dhe interesi i kandidatëve për të kandiduar ka qenë i vogël dhe një pjesë e tyre ashtu siç doli nga gjetjet e KED nuk plotësonin kriteret kushtetuese ligjore për të qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Ky proces i gjatë me 3 rishpallje ka bërë që afati ligjor i mandatit të parakohshëm të ish gjyqtarit Lulo të ngelet i shkurtër sepse mandati i tij ligjor mbaron në 24.03.22. Pra është një kohë shumë e shkurtër. Edhe sikur ne të kërkojmë të rishpallim në bazë të njoftimit që mund të na sjellë KED nisur nga gjendja aktuale që janë kandidatët sot, përsëri do të ndodhemi përpara një rreziku që ose nuk do kemi kandidatë ose kandidatët do të jenë të atij niveli që nuk do plotësojnë përsëri kriteret kushtetuese dhe ato të përcaktuara në ligj. Pra ky është një ndër arsyet për të cilën Kuvendi gjykon që procedura duhet të vazhdojë, arsye tjetër është fakti që

Kuvendi ka përpara disa rekomandime të Komisionit të Venecias ne lidhje me emërimin e gjyqtareve kushtetues. Një nga rekomandimet është pikërisht mandati i anëtarit të gjyqtarëve kushtetues i cili duhet të jetë i plotë dhe kur bëhet zëvendësimi i anëtarëve me mandat të përkohshëm. Por në kushtet në të cilën është procesi për plotësimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese është e vështirë që ky rekomandim të realizohet nga Kuvendi si organ ligjvënës. Ajo çka është me e rëndësishmja në këtë proces është pikërisht fakti që ngritja dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese sot është bërë një çështje imediate, jo vetëm nga faktori kombëtar dhe ndërkombëtar por dhe me sa jeni në dijeni vet Kryetari i Kuvendit ka patur takime me ambasadorin OSBE, SHBA të cilët insistojmë pikërisht ngritjen dhe funksionimin sa më parë të Gjykatës Kushtetuese. Është pikërisht kjo situatë e cila e detyron Kuvendin që pavarësisht atyre kornizave kushtetuese dhe ligjore të cilat siç tha Avokati i Popullit i japin të drejtën kuvendit të zgjedhje midis kandidatëve si organ emërtesës, t'i kërkoj KED vazhdimin e procedurave të vlerësimit dhe pikëzimit të atyre kandidatëve që ngelen pas vendimit të lejimit të kandidimit pa qenë nevoja të drejtohemi me shkresa njoftime kthim përgjigje.”

Shprehet që Këshilli të vazhdojë, me kandidatët të cilëve u lejohet vazhdimi i kandidimit me procedurën e vlerësimit e pikëzimit dhe sa më parë të vejë lista me kandidatët e ngelur në Kuvend për të vazhduar procedurën që parashikon Kushtetuta për zgjedhjen e tyre.

Vitore Tusha i jep fjalën përfaqësuesit të Presidentit.

Bledar Dervishaj: “Faleminderit zonja Kryetare, pyetja që shtrohet është delikate dhe shumë e rëndësishme në këtë moment. E parashitrova edhe pak më parë, pa dashur të bëjë një historik të gjatë mbi ecurinë procedurale të vakancës së Presidentit, e cila daton që prej mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit z.Sokol Berberi. Nga Presidenti kjo vakancë është shpallur në datë 07.02.2018. Pas shqyrtimit nga KED, është emëruar anëtari i Gjykatës Kushtetuese zoti Bensik Muci në tetor 2019 dhe është shkarkuar nga detyra ky gjyqtar në 22.11.2019. Në po të njëjtën ditë Presidenti ka rihapur garën dhe ka pasur kandidatë mjaftueshëm. Tashmë pas një viti në muajin shtator 2020 kjo vakancë ngeli me një numër me më pak se 3 kandidatë. Çështjet e kandidateve të skualifikuar shkuan në gjykatën administrative të Apelit dhe gjykata riktheu vetëm 2 prej këtyre kandidatëve. Ndërkohë po këtyre kandidatëve që u rikthyen në garë për këtë vakancë, ju ndalua kandidimi nga KED në mbledhjen e datës 23.11.2020, pikërisht në mbledhjen e kaluar. Relatoria e vakancës tjetër të Kuvendit, evidentoi nenin 32 të rregullores (Vendimin nr.4/2019 i KED) dhe rrjedhimisht sipas kësaj pike të ngresh një pretendim të tillë procedural në këtë kërkim dhe në këtë lloj mënyre do të thotë të shkosh pastaj tek referimi i nenit 49 i po të njëjtës rregullore. Kjo dispozitë parashikon se, “Këshilli mund të vendosë pezullimin e verifikimit dhe të njoftojë organin e emërtesës”.

Por nga ana tjetër, Këshilli ka dhe detyrime të tjera përveç asaj që citon rregullorja, ka dhe ato që parashikon ligji nr.115/2016, sipas të cilit me përfundimin e procedurës së verifikimit KED njofton kandidatët. Shpresoj që kandidatët e skualifikuar nga gara janë njoftuar, dhe nëse jo do të njoftohen dhe ata kanë të drejtën e tyre të ankimit. Këtë të drejtë kandidatëve nuk ja heq njeri. Ashtu si kundër është po ligji nr. 115/2016 që thotë në nenin 238 të tij se ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit.

Duke qenë në këto rrethana për të cilat ne të gjithë jemi njohur, pa menduar dhe pa paragjykuar se çdo të ndodhë me ankimet e mundshme, *(me ushtrimin ose jo të kësaj të drejte nga kandidatët e ndaluar, apo me rezultatet e proceseve gjyqësore)*, KED duhet të vijojë me zbatimin e nenit 237 dhe 238 të ligjit, dhe të hyjë në procesin e vlerësimit të kandidatëve që janë tashmë të kualifikuar. Ta përmbyllë procesin e vlerësimit. Është në të drejtë të Këshillit që të bëjë një njoftim paraprak tek organet e emërtesës (President, Kuvend) por ne e kemi marrë njoftimin, edhe nga njoftimi publik që ju keni bërë edhe nga pjesëmarrja jonë në mbledhje, kështu që, ose të bëjë një njoftim paraprak tani dhe në fund kur të mbyllë procesin e vlerësimit t'ia lerë organit të emërtesës të vendosë, kjo është e drejtë e Këshillit. Por që në këtë moment,

ne kërkojmë shpejtësi për të ringritur sa më shpejt Gjykatën Kushtetuese. Unë e kam kërkuar dhe në mbledhje të tjera hyrjen në proces dhe nuk jam shprehur kot që Këshilli duhet të kryejë sa më parë, verifikim, por kam thënë vlerësim dhe pikëzim të secilit kandidat. Ne e dimë që proceset janë të ndara. Kështu që, tek vakanca jonë është mbyllur verifikimi dhe Këshilli sipas ligjit mund të fillojë vlerësimin. Pastaj vijueshmëria e proceseve gjyqësore është tjetër gjë, por që ligji siç citova dhe më sipër, e lejon hyrjen në procesin e vlerësimit dhe pikëzimit dhe ky proces nuk pengohet nga fakti, nëse ka ankim gjyqësor, apo jo.”

Vitore Tusha pyet përfaqësuesit e organeve të emërtesës nëse kanë autorizim të plotë për këto deklarime.

Bledar Dervishaj: Po.

Vitore Tusha pyet nëse janë dakord që Këshilli të vijojë me procedurën e pikëzimit dhe vlerësimit për kandidatët e lejuar, duke qenë se ky është një disponim i fortë që lidhet me një disponim të shprehur të vullnetit.

Bledar Dervishaj: “E theksoj, kjo procedure sipas nenit 238 të ligjit nr 115/2016, nuk pengohet nga fakti nëse ka apo jo ankim. Këtë e thotë ligji, dhe kjo nuk kërkon autorizim, e ka thënë Kuvendi me ligj. Ne sot jemi përballë fakteve se nuk e dimë nëse do të ketë proces gjyqësor. Nëse mund të zhvillohet një proces gjyqësor, nuk mund ta dimë se do të pranohet apo rrëzohet kërkimi. Ne sot ndodhemi përpara faktit që sot kemi vetëm dy kandidatë të kualifikuar dhe nuk e dimë se sa do të jetë ky numër deri në fund, ndërkohë që mund të ketë dhe procese gjyqësore. Nuk e dimë atë, mund të jemi përpara faktit që numri i kandidatëve ngelet kështu siç është, dhe në këtë mënyrë pas listimit të kandidatëve, ne do ta vlerësojmë në fund.”

Vitore Tusha kërkon që Këshilli ta rivlerësojë edhe njëherë, duke marrë në konsideratë qëndrimin e shprehur të organeve: “Në këtë mbledhje u prezantua shqetësimi mbi gjendjen e vakancave, ndërkohë duke qenë se ka një qëndrim të përfaqësuesve të organeve të emërtesës, Këshilli duhet të shprehet edhe njëherë, sepse ata kërkojnë një vendim të mëtejshëm të Këshillit.”

Fiona Papajorgji merr fjalën dhe duke qenë se diskutimi u kanalizua në drejtim jo të marrjes nga ana e Këshillit të një vendimi, por të një kërkimi të një informacioni nga organet e emërtesës dhe në këtë drejtim përfaqësuesit e organeve të emërtesës u shprehën që nuk ka nevojë për këtë informacion, mendon se nuk duhet të procedohet me informacion, por të vazhdohet me procedurën e vlerësimit.

Arta Marku shprehet se përgjigjet që Këshilli do të kërkonte me shkresë erdhën dhe nuk është e nevojshme të kërkohet një informacion i tillë.

Ludovik Dodaj shprehet se situata u sqarua nga përfaqësuesit dhe është krejt e panevojshme të merren me këtë pjesë, pasi nuk është nevoja për informacion.

Saida Dollani shprehet se duke falënderuar përfaqësuesen e Kuvendit që tha se Këshilli mund të vazhdojë, i ka marrë masat duke dhënë informacionin real dhe duke shkurtuar shumë kohë në procedura, mbas relacionit të sotëm dhe mbas vendimmarrjes të ditës së sotme të procedohet me vlerësimin paraprak të pikëzimit ashtu siç thotë neni 240 i ligjit nr.115/2016 për hapat e mëtejshëm. Në lidhje me vërejtjen e zv/Kryetarit paraqet kërkesën me shkrim dhe e depoziton.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe ndan një mendim ndryshe. Nuk vë në dyshim autorizimin që kanë përfaqësuesit e institucioneve që t'i thonë Këshillit të vazhdojë, por gjykon që për formalitet të informohen institucionet. Zyrtarisht Këshilli të dalë me një informacion për situatën, qoftë dhe për vendimin e Këshillit, duke iu referuar asaj që është përcjellë në mbledhje dhe që do të vijojë me pikëzimin e kandidatëve.

Vitore Tusha përmbledh diskutimet, duke u shprehur se u dakortësua që Këshilli të informojë organet e emërtesës për gjendjen në të cilën janë vakancat dhe për hapat proceduralë në të cilët ai është duke operuar, pra që do të vazhdojë procedurën paraprake në lidhje me këto dy vakanca.

Vijon me pikën tjetër të rendit të ditës, miratimi i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së datës 23.11.2020.

Anëtarët miratojnë procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së datës 23.11.2020.

Vitore Tusha vijon me pikën tjetër të rendit të ditës: procedura e verifikimit të kandidatës Aldona Sulaj, për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, i shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.18 dhe të rishpallur në datat 27.09.2019 dhe 24.09.20. Në cilësinë e relatores, sipas shortit të datës 20.10.2020, fillon me relatimin e gjetjeve në procedurën e kësaj kandidateje. Lexon të plotë relacionin. Sqaron se relacioni i është komunikuar kandidatës, anëtarëve, Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara, që sipas ligjit u lejohet të marrin pjesë dhe është njoftuar publikisht si pjesë e rendit të ditës në faqen e Gjykatës së Lartë.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje nga anëtarët dhe nga Avokati i Popullit.

Erinda Ballanca pyet nëse pas njoftimit të relacionit a ka pasur reagim nga kandidatja?

Vitore Tusha përgjigjet se deri në momentin që kanë hyrë në mbledhje nuk ka pasur asnjë reagim dhe se pas njoftimit të relacionit nuk ka asnjë komunikim tjetër. Në kohën që i janë prezantuar gjetjet paraprake dhe e drejta për të marrë dokumentet, kandidatja ka paraqitur shpjegime dhe dokumente në mënyrë të vazhdueshme dhe të gjitha janë marrë dhe janë përfshirë në relacion.

Erinda Ballanca shprehet se është e qartë në lidhjet me gjetjet e paraqitura në relacion për kriterin e vjetërsisë. Pyet nëse relatorja i ka lënë kohë kandidatës për të plotësuar ato gjetje apo për të sqaruar apo trajtuar ato gjetje që kanë të bëjnë me vlerësimin e pasurisë apo me kriterin e pasurisë. Pra nëse ka pasur një kohë të mjaftueshme dhe a ka kërkuar nga kandidatja më shumë kohë për të mbledhur informacion.

Vitore Tusha përgjigjet se nuk ka pasur një kërkesë në mënyrë të shprehur për më tepër kohë. “Ndërkohë unë e kam lexuar më tepër si një justifikim për mosparaqitjen e dokumenteve në fillimin e aplikimeve, për shkak të formatit me të cilin duheshin paraqitur dhe për shkak të kohës që i duhej. Megjithatë mbetet në vlerësimin e gjithsecilit të lexojë atë çka është shkruar në dokumentin e saj, po dhe të vajzës, e cila është përcjellë bashkëlidhur në *e-mail* e komunikuar Këshillit dhe janë marrë në konsideratë”.

Vijon me relatimin e kandidaturës së kandidatit Shaqir Hasanaj, i cili ka shpallur interes në vendin vakant për Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe të rishpallur në datat 27.09.2019 dhe 24.09.2020. Në cilësinë e relatores parashtron relatimin për këtë kandidat dhe lexon të plotë relacionin. Sqaron se ky relacion së bashku me shpjegimet e tij dhe me gjithë dokumentacionin e administruar i është bërë prezent. Pas marrjes së relacionit kandidati nuk ka komunikuar dhe nuk ka sjellë asnjë informacion në këshill. Sqaron se relacioni i është komunikuar kandidatit, anëtarëve, Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara, që sipas ligjit u lejohet të marrin pjesë dhe është njoftuar publikisht si pjesë e rendit të ditës në faqen e Gjykatës së Lartë.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje nga anëtarët dhe nga Avokati i Popullit.

Erinda Ballanca: “Ne kemi një problem që të korrigjohet në vijimësi. Konkretisht ne qëndrimi i kandidatit nuk na ka ardhur fare si pjesë e materialeve të dosjes vetëm e kam parë këtë aspekt si pjesë të relacionit. Nuk na ka ardhur bashkëlidhur dokumentacioni që ju keni dërguar për shkak se ka qenë një komunikim me e-mail i drejtuar drejtpërdrejt te secili prej jush me sa duket dhe nuk ka qenë pjesë e materialeve të dosjes. Pavarësisht këtij fakti ky nuk është një qëndrim i cili është i ri paraqitur nga kandidati edhe në seancat gjyqësore që në kemi marrë pjesë dhe për këtë arsye unë nuk e konsideroj se do të më duhej kohë për ta vlerësuar edhe me tej por më tepër kam për ta saktësuar në kuadër të vlerësimit të materialeve dhe të dokumenteve. Unë jam e kënaqur që nuk është konsideruar si gjetje çështja e pengesës për shkak të qenit këshilltar në institucionet e pavarura sepse ky ka qenë një qëndrim i mëparshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit përse i përket kandidimeve të mëparshme të ngjashme.

Dhe sa i përket gjetjeve të tjera do trajtohen nga këshilli në vendimmarrje sepse nuk i përkasin drejtpërsëdrejti mandatit tonë.”.

Vitore Tusha shprehet se mosvënja në dispozicion të Avokatit të Popullit e qëndrimin të kandidatit mund të jetë një pakujdesi për shkak të volumit të punës dhe që nuk është aspak e qëllimshme dhe se sekretaria është duke e sjellë tashmë. Pyet Avokaten e Popullit nëse ka diçka për procedurën.

Erinda Ballanca shprehet se nuk ka ardhur ky dokument dhe se nuk ka gjetje problematike.

Vitore Tusha fton relatoren Saida Dollani për të relatuar gjetjet për kandidaturën e kandidatës Ardita Buna (Alsula), për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datat 21.08.2019 dhe 24.09.2020. Njofton se anëtarja e Këshillit, zonja Fatjona Memçaj për shkak të qenies në konflikt interesi me kandidaten është larguar dhe nuk është e pranishme në mbledhje, e cila vijon me kuorumin e 5 anëtarve.

Saida Dollani relaton gjetjet në procedurën e kësaj candidate. Sqaron se zonja Ardita Alsula ka qenë edhe më parë candidate në këtë vakancë por të rishpallur në datën 21.08.2019 ndaj së cilës është proceduar nga Këshilli me vendim ndalimi, vendim i cili është bërë pjesë e kësaj procedure dhe që sot kemi në shqyrtim nëpërmjet disponimit të relatorit. Kandidatja është njoftuar si për relacionin ashtu edhe për mbledhjen e sotme.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje nga anëtarët dhe nga Avokati i Popullit.

Erinda Ballanca: “Zonja Buna parashikon ose pretendon se ka disa çështje apo gjetje të reja, apo disa ndryshime të situatës së saj juridike nga raportimet e mëparshme apo vlerësimet e mëparshme që janë bërë nga ana e këtij Këshilli i vlerësimit të pasurisë së saj. A kanë sjellë këto ndryshime ndonjë ndryshim përsa i përket gjetjeve? Unë shikoj që gjetjet nuk kanë ndryshuar nga ana e ILDKPI-së, pavarësisht, fakteve, provave apo pretendimeve, apo deklarimeve të bëra nga vetë kandidatja?”

Saida Dollani përgjigjet se në raport me të mëparshmen, bëhet fjalë se pasaktësi ka pasur dhe për një banesë. “Tani nuk e shikon më ILDKPI-ja. ILDKPI-ja, më lejoni të them zonja avokat, se i ka parë me vëmendje, sepse e kisha parasysh që do ta bënit këtë pyetje! Domethënë e kam parë këtë gjë. Por në lidhje me garazhdin ka të njëjtin konkluzion dhe i shtohet edhe llogaria bankare e vajzës, duke ditur që është studente. Sigurisht që do ta vazhdoni pyetjen tuaj për të dhënë që po në gjetjen e mëparshme ka rezultuar, ok. Unë i bëra prapë një hetim dhe vërejtja se në të mëparshmen vajza ka deklaruar dhe i kam përpara në fakt se i kam marrë të dyja sot. Është deklarimi i Alisa Gjoka ka thënë që llogarin në Intesa SanPaolo Bank, shkollimin e nevojshëm për të kryer studimet në Itali. Vlera 6 mijë e 300 euro, burimi është llogaria të vura në bankën Intesa SanPaolo Bank, e cila u mbyll po kështu dhe llogaria juaj u mbyll dhe shuma në atë llogari prindërit ma kaluan mua me qëllim shkollimin si dhe kredia që prindërit mori babai Gjok Buna në Union Bank në emër të Biznesit Albjuris në gusht 2019. Dhe këtë e kanë gjetur përputhje deklarimi me dokumentacionin aktual. Tek kjo e tanishme, thuhet: llogari studenti pranë Intesa SanPaolo Bank Itali nr... , ka vënë edhe numrin, burimi është llogaria në bankën e cila u mbyll po kështu edhe llogaria e huaj, ka vënë edhe pastaj shpjegimet. Për këtë ka thënë, nuk është paraqitur dokumentacion ligjor në llogarinë Intesa SanPaolo Bank Itali dhe këtë ja ka quajtur, mungesë, pasaktësi”.

Bledar Dervishaj pyet nëse është mungesë dokumentacioni.

Saida Dollani përgjigjet: “Duke qenë nga përvoja është po: nëse pretendon se atje ke një llogari duhet të biesh ekstraktin e asaj llogarie si dhe të gjithë deri në fund se çfarë ti ke. Tregon vetë llogaria. Kur e ke hapur dhe gjendjen aktuale që t’i pretendon. Duhet të përputhet deklarimi dhe me atë të sjellë, që ka paraqitur kandidati tek ILDKPI-ja. Se të gjithë këto paraqiten atje bashkë me deklaratën. Deklarata për çdo deklaram që bën i bashkëngjitet prova, dokument.”

Vitore Tusha vijon me relatimin në lidhje me gjetjet për kandidaturën e zonjës Ardita Buna (Alsula) për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, dhe të rishpallur në datat 27.09.2019 dhe 24.09.2020, në cilësinë e relatores së kësaj vakance. Relaton çështjen sipas relacionit. Sqaron se janë bërë të njëjtat hapa proceduralë dhe se shkresat drejtuar institucioneve publike dhe jopublike kanë qenë standarde, kurse shkresat e tjera apo komunikimet e natyrës personale janë harmonizuar edhe me ato që ka pasur relatorja, zonja Dollani. Janë drejtuar pyetje të përbashkëta dhe janë pasqyruar në të dyja relacionet.

Erinda Ballanca: “Në lidhje me procedurën e ndjekur nga Këshilli, përsa i përket kësaj kandidature. Mendojmë se nuk ka probleme të karakterit procedural. U evidentuan disa nga pyetjet që unë kisha që kishin të bënin me ndryshimin e rastit konkret sepse edhe në raportin e ILDKPI-së ka një diferencë edhe përsa i përket të ardhurave. Thotë që kanë ndryshime të ardhurat sipas deklaratave në raste të ndryshme, kanë qenë të ndryshme dhe për këtë arsye, kjo ishte dhe pyetja ime për të dalë qartë edhe përpara të gjithë anëtarëve të Këshillit. Sigurisht që keni lexuar dosjet po duket se kanë një diferencë dhe ka një dallim, për këtë arsye do të doja të tërhiqej edhe njëherë vëmendja e anëtarëve në këtë çështje, por nuk shoh probleme të karakterit procedural përsa i përket gjetjeve. Pastaj, përsa i përket dy kritereve të tjera nuk kam asnjë koment që qëndrimi të ishte i ndryshëm nga ai që është paraqitur në relacione. Pra, nëse ka një çështje për tu trajtuar ajo ka të bëjë vetëm me njërin prej kritereve të paktën në gjykimin e Avokatit të Popullit. Çështjet e tjera, gjetjet e tjera janë në përputhje me ato që ka dalë vetë relacioni, përsa i përket dy kritereve të tjera. Faleminderit!”

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje apo komente përpara se të vijohet me vendimmarrjen.

Mimoza Arbi përsërit atë çka ka parashtruar më parë, që duke u nisur nga koha e shkurtër që ka dhe vetë Kuvendi për mbarimin e legjislaturës së dytë dhe koha e shkurtër e vetë veprimtarisë të kësaj KED-je, pasi në 05 dhjetor Presidenti hedh shortin për KED-në e vitit 2021, si dhe domosdoshmërinë e ngritjes së Gjykatës Kushtetuese, kërkohet koordinim, pavarësisht ngarkesës që kanë anëtarët e KED-së si gjyqtarë, për të bërë mbledhje të vazhdueshme për të miratuar sa më parë listën e renditur e kandidatëve që mbeten në kandidim, cilido qoftë numri i kandidatëve që do të pjesë e kësaj liste.

Bledar Dervishaj: “Nga sa u relatua dhe nga gjendja e kandidaturave të verifikuara deri më tani, ne vlerësojmë, se ekzistojnë të gjitha mundësitë që përkundrejt gjithë kohës së mbetur, *(se mandati i këtij këshilli është deri më 31 dhjetor)*, këshilli të përfundojë shqyrtimin e të tre vakancave. Ky KED, 2020-ta, duhet të mbyll verifikimin, vlerësimin, pikëzimin e të gjitha kandidaturave për të 3 vakancat (dy të Presidentit dhe një të Kuvendit). Ne e vlerësojmë këtë fakt, bazuar në ecurinë e deritanishme dhe procedurat që do të duhet të ndjekë KED dhe që unë më duhet ti kujtoj. Jo se ju nuk i dini, po ne shprehim këtu çfarë ne kërkojmë, sepse ju e dini vetë se çfarë kërkon Ligji, Kushtetuta dhe aktet nënligjore, por që çdo gjë duhet të jetë me përparësi, edhe pse na sfidon situata pandemike. Së pari, KED për ato vendime që do të marri sot, të kaloj me zbardhjen automatike të vendimeve, dhe njoftimin e kandidatëve për vakancën qoftë të zotit Besnik Imeraj, por edhe të vakancës së Kuvendit sipas vendimmarrjes, qoftë për lejimin, qoftë për ndalimin e kandidimit që do marri Këshilli. Gjithashtu, të përfundojë mbledhjen e dokumentacionit, të verifikimit dhe futjen në proces relatiimi sa më shpejt të dy kandidaturave të ngelura të zotit P.Kalo dhe zotit K.Mone, që janë kandidaturat e fundit në vakancën e Presidentit dhe marrjen e një vendimi edhe për këto dy kandidatura sa më shpejt dhe njoftimin e vendimeve përkundrejt kandidatëve. Njëkohësisht të vijohet me vlerësimin, intervistimin, tamam procedurën sesi do ta ndiqni dhe ju besoj sipas radhës që thotë ligji, vlerësimin, intervistimin dhe pikëzimin e secilës kandidaturë për vakancën e Presidentit të Republikës, ku tashmë janë më pak se 3 (tre) kandidatë dhe kanë ngelur 2 (dy) kandidatë dhe të vakancës së Kuvendit. Njëkohësisht, ndjekjen edhe të ecurisë procedurale të atyre proceseve gjyqësore që mund të hapen, apo munden të krijohen nga kandidatët e ndaluar qoftë për

vakancën e Presidentit, qoftë në vakancën e Kuvendit dhe pas kësaj, të vijohet me renditje. Ne do të kemi mundësinë sërish që të shprehemi, dhe pastaj tek Presidenti apo tek Kuvendi ngelet fjala e fundit kur këto dokumente të vijnë tek organet e emërtesës. Kështu ne kërkojmë që asnjë vonesë mos të ketë dhe çfarë keni nevojë nga ana e organeve të emërtesës, mund të na i bëni me dije.”

Vitore Tusha shprehet, në emrin e saj, por edhe të të gjithë anëtarëve, se përpjekja e të gjithëve ka qenë maksimale në të gjithë ecurinë e kësaj veprimtarie. Po ashtu, ka qenë maksimale për të ecur me shpejtësi dhe kjo evidentohet edhe nga datat e shkresave dhe të komunikimeve. “Maksimalisht është përpjekur të respektohet ligji për të qenë sa më korrekt. Edhe në ditët në vijim do të bëhet i njëjti vlerësim në lidhje me shpejtësinë, duke e parë si çështjen e parë dhe detyrën e parë në këtë moment dhe asnjë nuk do të ngelë për kohën që do të duhet në lidhje me vijimin e pikëzimit apo të vlerësimit të kandidatëve. Kjo është një çështje që po përballohet më së miri në kapacitetet intelektuale që ka gjithsecili prej anëtarëve të Këshillit, edhe me kohën që do të kenë në dispozicion të kësaj procedure. Sot u mor një gjë shumë të mirë, një premtim që Këshilli duhet të vijojë pa pyetur më nëse duhet të ketë rihapje vakance apo jo. Meqenëse ka kandidatë të lejuar u mor një garanci që duhet të vijojë me vlerësimin e tyre për procedurat paraprake edhe referuar procesit të rregullt ligjor”.

Deklaron mbylljen e mbledhjes për të vijuar me pikën tjetër të rendit të ditës, procedurën e vendimmarrjes për kandidatët.

Mbledhja mbyllet në orën 18.06.

Tiranë, më 26.11.2020

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore TUSHA

ANËTARE

Arta MARKU

ANËTARE

Fiona PAPAJORGJI

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore TUSHA

ANËTARE

Fatjona MEMÇAJ

ANËTAR

Ludovik DODAJ

ANËTARE

Saida DOLLANI

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Elona KARDHIQI

Vilma DOKUSHI

Dorina DULAJ